



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Nr.i Regj.Them.(21255-04043)2608 Datë regj. 30.11.2017
Nr. i Vendimit (11-2017-6330)2066 Datë Vendimi 14.12.2017

SHKURTIM-V E N D I M I

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Durrës e përbëre prej:

Mimoza Margjeka - Gjyqtare

Asistuar nga sekretare gjyqësore Manuela Joanidhi, në Durrës, sot me datën 14. 12. 2017, shqyrtoi në séance gjyqësore publike çështjen civile Nr. 2608 Akti, që u përket palëve ndërgjyqësua :

Paditës : 1.Doni Sokolaj i biri i, Gjelosh Miloard dhe i Rosamaria, dtl.16.11.1969, lindur në Rijeka Kroaci, dhe banues në Lushnje, lagja “Kadri Qystri”, perfaqesuar me deklaram ne seance nga av. Bilbil Gjana.

2.Gjovana Sokolaj e bija e, Kol e Age,dtl.4.3.1983, lindur në Iballë, Pukë dhe banues në Lushnje, lagja “Kadri Qystri”, perfaqesuar me deklaram ne seance nga av. Bilbil Gjana.

Të paditur: **1.Përmbarues Gjyqësor Valter Kaçupi**, adresa Zyra Përmbarimit “Strati Bailiff’s Service”, rruga “Jordan Misja”, Tiranë, perfaqesuar nga juristja Berjola Shehu.

OBJEKTI : Marrja e masës "Sigurim Padie" për pezullimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit nr.6415, datë 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Anullimin e veprimit permbarimor, datë 20.11.20 17 të Përmbaruesit Valter Kacupi(procesverbal kreditor permbarues).

Anullimin e vndimit te permbarusit , datë 20.11.20 17 per shpalljen e fituesit te ankandit.

BAZA LIGJORE : Nenet 610, 616 të Kodit te Proçedurës Civile.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen

V E N D O S I :

Pranimin e kërkesëpadisë së paditësave Doni Sokolaj, Gjovana Sokolaj.

Anullimin e veprimit përmbartimor, vendimit të përmbartuesit Valter Kaçupi datës .20.11.2017, për shpalljen e fituesit të ankandit.

Anullimin e veprimit përmbartimor të përmbartuesit Valter Kaçupi te datës 20.11.2017, procesverbal gjatë zhvillimit të ankandit

Marrja e masës, sigurim padie, pezullimin e veprimeve përmbartimore në zbatim të Urdhrit të Ekzekutimit nr.6415, date 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Kundër vendimi për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, kundër vendimit për marrjen e masës së sigurimit të padisë lejohet ankim brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar këto afate nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.

Durrës më datë 14.12.2017

GJYQTARE
MIMOZA MARGJEKA

